

D E K R E T
Nr.1511, datë 29.6.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7678, DATË 3.3.1993 “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISE”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 8083, DATË 7.3.1996

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J :

Neni 1

Shkronjat “c”, “ç” dhe “g” të nenit 3 të ligjit nr. 7678, datë 3.3.1993 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 8083, datë 7.3.1996, ndryshohen si vijon:

c) Pije të buta dhe freskuesePërqindja e akcizës

- vendi5

- importi30

ç) Ujë mineral dhe i gazuar

- vendi-

- importi20

g) Nënproduktet e naftës:

- benzinë deri 89.9 oktan

- vendi53

- importi60

- Benzinë 90 oktan e lart50

- Gazoil:

- vendi49

- importi40

- vajguri prodhim vendi me çmim të liberalizuar 16

Në zërin “Të tjera” fjalët “e artikuj të ngjashëm me to”, hiqen.

Shtohet ky zë:

- Importimi i çdo lloji nënprodukti naftë që nuk përfshihet në shkronjën “g” do të trajtohet me akcizë 100 për qind.

Në paragrafin e parafundit të po këtij neni, pas fjalëve “në shkronjën “g” të këtij neni”, të shtohen fjalët “dhe taksën e qarkullimit rrugor”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi më 1 korrik 1996.

KUNDËRFIRMOHET
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Aleksandër Mexsi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Sali Berisha